



## NEWSLETTER

Tetor 2023

Nr.10

### U mbajtën "Ditët e Arsimimit Mediatik 2023"



Nën moton "Gisht i shpejtë, lajmet e rreme sjellin", duke filluar nga data 24 deri më 31 tetor, në organizimin e Rrjetit të Arsimimit Mediatik për herë të pestë u mbajt manifestimi Ditët e Arsimimit Mediatik 2023. Në këtë mënyrë vendi ynë iu bashkua Javës Globale të arsimimit dhe informimit mediatik të UNESCO.

Ditët u hapën me Konferencën "Arsimimi mediatik në hapësirat digjitale", në të cilën drejtori dr. Zoran Trajčevski, theksoi se "motoja e Ditëve pasqyron atë që do të bëjmë këtë periudhë - do të përkujtojmë, vazhdimisht dhe me këmbëngulje, se atë që nuk e bëjmë në realitet, nuk duhet ta bëjmë as në realitetin virtual. Dhe në hapësirat digjitale kemi të njëjtat të drejta të njeriut, kufiri i të drejtave tona është vendi ku fillojnë të drejtat e të tjerëve dhe është më se e nevojshme të kuptohet dhe të pranohet se sa është i rëndësishëm dhe i nevojshëm arsimimi mediatik në arsim".

Në kuadër të Konferencës u mbajtën dy panele dhe një punëtori. Paneli i parë i organizuar nga Fondacioni Metamorfozis si pjesë e projektit të Qendrës Kundër Dezinformimit në Ballkanin Perëndimor, iu kushtua ndërtimit të rezistencës sociale ndaj influencës së dëmshme të dezinformimit, ndërsa i dyti i organizuar nga MIM dhe IREKC, në kuadër të Projektit USAID për Arsimimin Mediatik "Të rinjtë mendojnë", për ndikimin e botës digjitale mbi fëmijët dhe të rinjtë. Punëtorja "Përmes digjitalit – sfidat e reja për arsimimin mediatik?" u organizua nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale me eksperte siguruar nëpërmjet IPA Tvinging projektit "Forcimi i kapaciteteve të ASHMA-së dhe TVM-së".

Për nevojat e Ditëve të Arsimimit Mediatik 2023, janë realizuar video dhe audio spot në maqedonisht, shqip dhe anglisht.

Më shumë informacione për ngjarjet që ndodhën drejtpërdrejt dhe online në kuadër të Ditëve, janë të disponueshme në ueb-faqent [mediumskapismenost.mk](http://mediumskapismenost.mk) dhe [avmu.mk](http://avmu.mk) dhe në kanalin Facebook, Instagram dhe YouTube të Rrjetit për arsimimin mediatik.

### Promovoi Kodin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve




Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, me mbështetjen e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) e OSBE-së, më 12 tetor promovoi Kodin e Sjelljes në hapësirën online gjatë proceseve zgjedhore dhe referendumeve. Kodi është përpiluar me iniciativë të Agjencisë në bashkëpunim me institucionet përkatëse në këtë fushë - Asociacioni i Gazetarëve të Maqedonisë, Instituti Maqedonas për Media, Këshilli për Etikë në Media, Instituti për Studime të Komunikimit dhe Fondacioni Metamorfozis.

"Parimet dhe standardet e parashikuara në Kod janë të natyrës etike, për këtë arsye respektimi i tij është në baza vullnetare, duke nënshkruar formular pranimi. Mjedisi digjital ka sjellë tendenca të reja dhe sfida të shumta: taktika të reja për reklamim politik, udhëheqje të fushata dhe financime, marketing të informacionit jo të plotë, të pasaktë ose keqdashës. Gjithnjë e më shpesh në rrjetet sociale dhe në përgjithësi në hapësirën online përdoren format e shprehjes që mund të nxisin klimë të intolerancës, urrejtjes, dhunës dhe diskriminimit, gjë që ishte arsyeja e miratimit të Kodit", tha drejtori i ASHMA-së Zoran Trajčevski. Në të njëjtën kohë, drejtori Trajčevski theksoi se në procesin e përgatitjes së tij janë shfrytëzuar përvojat dhe ekspertiza e OSBE/ODIHR-it, ndërsa vlerësime pozitive dhe mbështetje për Kodin ka dhënë dhe ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, z. Azir Aliu dhe Ambasadori i Misionit të OSBE-së z. Killian Wahl.

Në aktivitet u prezantua edhe mënyra e funksionimit dhe roli i Trupit Koordinues, i cili do të monitorojë respektimin e parimeve dhe standardeve të përcaktuara në Kod nga partitë politike, kandidatët e tyre, kandidatët e pavarur, edicionet në internet të transmetuesve, mediat online, kontrolluesit e fakteve, ndikuesit dhe subjektet e tjera që mund të ushtrjnë ndikim në publik në funksion të fushatës gjatë fushatës zgjedhore ose referendumeve. Në të njëjtën kohë, u prezantua ueb-faqja e re [www.izborenkodeksonline.mk](http://www.izborenkodeksonline.mk), e përpiluar me qëllim në funksion për njohjen e publikut me Kodin dhe punën e Trupit Koordinues. Faqja është e disponueshme në maqedonisht, shqip dhe anglisht dhe është përshtatur për personat me shikim të dëmtuar.

Pikëpamjet e tyre për Kodin dhe zbatimin e tij në praktikë ndanë dhe përfaqësuesit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, Agjencisë për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin me Karakter Publik dhe Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Më shumë informacion rreth ngjarjes dhe dokumentet përkatëse janë në dispozicion në [www.izborenkodeksonline.mk](http://www.izborenkodeksonline.mk).



## NEWSLETTER

### Dënim i qëndrimit të pushtetarëve ndaj gazetarit të TV Alfa

Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale më 14 tetor nëpërmjet një lajmërimi dënoi qëndrimin jokorrekt të kryeministrit Kovaçevski dhe zëvendës kryeministrit për çështje ekonomike Fatmir Bitiqi ndaj gazetarit Mateja Petrovski nga TV Alfa.

Në njoftim është theksuar se mediat janë një nga shtyllat kryesore të demokracisë dhe kanë rol të rëndësishëm në krijimin e mendimit kritik dhe raportimit për çështje që janë me interes publik. Nga këtu, nuk guxon të ekziston mënyrë komunikimi që është e papërshtatshme dhe fyese ndaj gazetarëve, dhe për të gjithë publikun, të cilit duhet t'i përcillen informacionet. Bartësit e funksioneve publike duhet të bëjnë përpjekje maksimale për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve gazetareske që janë me interes publik dhe në të njëjtën kohë të tregojnë respekt ndaj profesionit të gazetarit dhe dinjtetit të punonjësve të medias.

### Mbikëqyrja e transmetuesve, operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe medias së shkruar

#### Transmetuesit

Mbikëqyrje të rregullta programore dhe administrative për disa detyrime ligjore - për respektimin e rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtjen e audiencës së mitur, përdorimin e shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimit telefonik, transmetimin e lojërave të fatit dhe ofrimin e kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrja në lojërat shpërblyese, shpallje për impresium, informacioni që duhet t'u vihet në dispozicion përdoruesve dhe për shpalljen e identifikimit të transmetuesit, përdorimi i gjuhës në programe, transmetimi ditor prej së paku 12 orë program televiziv dhe transmetim ditor prej të paktën 40%. Program burimor si vepra audio dhe audiovizuale maqedonase janë kryer mbi TV programet e Shërbimit Publik - MRT 1, MRT 2, MRT 3, MRT 4 dhe MRT 5. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se MRT 3 më 4 tetor 2023, në pjesë të programeve të transmetuara, nuk ka publikuar të dhënat që është i detyruar t'i transmeton në vendin e përshtatshëm për çdo përmbajtje të shërbimit programor. Ligjin nuk e kanë respektuar dhe MRT 4 dhe MRT 5 të cilët nuk kanë transmetuar të paktën 40% programi të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Është kryer dhe mbikëqyrje e rregullt programore dhe administrative mbi radiot Rosa - AB, Zona M-1, RFM, Skaj dhe EF-EM 90.3 Radio Sportive, për detyrimet ligjore në lidhje me publikimin për impresium, informacion që duhet të vihet në dispozicion të përdoruesve dhe detyrimeve për identifikimin e transmetuesit, respektimi i rregullave gjatë transmetimit të komunikimeve komerciale audiovizuale, mbrojtja e audiencës së mitur, përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik, transmetimi i lojërave të fatit, ofrimi i kuizeve ose formave të tjera të pjesëmarrjes në lojërat e fatit, përdorimi i gjuhës në programe, transmetimi ditor i së paku 12 orë program në radio dhe transmetimi i përqindjes së regjistruar vullnetare të muzikës maqedonase. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se EF-EM 90.3 Radio Sportive në programin e transmetuar më 5 shtator, as në shpicën lajmëruese, as në shpicën çajmëruese nuk i publikoi të dhënat për impresium në tërësinë e lajmeve në radio me titull: "Lajme sportive të 90.0 EF-EM" ndërsa Radio Skaj Teodor në programin e transmetuar më 4 shtator nuk ka transmetuar të paktën 10% muzikë në gjuhën maqedonase transmetuar në periudhën prej orës 6:00 deri në ora 24:00.

Për të konstatuar nëse është vepruar sipas aktvendimit për ndërmarrjen e masës vërejtje publike, për shkak të mospublikimit të impresium dhe mosrespektimit të rregullave për transmetimin e komunikimeve audiovizuale, Agjencia ka kryer mbikëqyrje të kontrollit programor dhe administrativ mbi Radio Metropolis. Nga mbikëqyrja e kryer e kontrollit është konstatuar se Radio Metropolis në programin e transmetuar më 26 shtator, as në shpicën lajmëruese dhe as në shpicën çajmëruese nuk ka publikuar të dhënat për impresium në tërësinë e lajmeve në radio me titull: "Një minutë fakte pozitive – sipas informacioneve të marra nga Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjiko-Industriale dhe Këshillit të Investitorëve të Hua", si dhe në pjesët argëtuese-informative: "Mirëmëngjes / Mirëdita me Majën - Maja për gatimin dhe menopauzën" dhe "Bota në 4 me Vikin dhe Stelën". Në të njëjtën ditë në mënyrë të paligjshme janë sponsorizuar edicionet e lajmeve, respektivisht edicionet e emisioneve të shkurtra informative me titull: "Sporti i Metropolit" dhe "Një minutë fakte pozitive".

Mbikëqyrje kontrolli janë kryer edhe mbi TV Kiss&Menada, për të përcaktuar nëse transmetuesi ka vepruar sipas masave të shqiptuarapër vërejtje publike, drejtuar për mospublikim të impresium, informacioni që duhet t'i vihet në dispozicion përdoruesve dhe përdorimi i gjuhës së programit në kundërshtim me Ligjin. Nga mbikëqyrja u konstatua se transmetuesi i ka përmbushur plotësisht detyrimet ligjore.



## NEWSLETTER

Sipas detyrës zyrtare, është kryer mbikëqyrje e jashtëzakonshme programore mbi punën e Radio Kanal 77 në lidhje me pretendimet e paraqitura në seancën publike, e cila u mbajt në ambientet e Agjencisë më 22.8.2023, me qëllim që të konstatohet nëse transmetuesi po vepron në pajtim me nenin 68, dhe në lidhje me nenin 3 paragrafi (1) pika 12 nga LSHMAAV. Me mbikëqyrjen e jashtëzakonshme u konstatua se ka dallime në strukturën e shërbimit programor të Radio Kanal 77 që transmetohet në dy frekuenca (89.70 Mhz nga Vodno vrv dhe 101.90 Mhz nga Popova Shapka) të cilat janë pjesë e rrjetit të frekuencave që ky transmetues përdor për të transmetuar shërbim në radio në nivel shtetëror. Kjo është në kundërshtim me dispozitat e përmendura ligjore, për faktin se transmetuesi nga Agjencia ka marrë vetëm një leje për transmetimin e shërbimit programor në radio në nivel shtetëror. Kjo do të thotë që i njëjti shërbim duhet të transmetohet përmes të gjitha frekuencave të përdorura nga transmetuesi për të mbuluar zonën për të cilën ka marrë lejen.

### Operatorët e rrjeteve publike të komunikimit elektronik

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore mbi operatorët Drim Sat IPTV, Nafi dhe Beko, Vinsat Kable, Multimedia Network L, Shkupi Kable, Telenet Kom, Signal-Net dhe SkrmbeL për detyrimin që në paketën programore që ata ritransmetojnë detyrimisht dhe pa pagesë të ofrojnë shërbimet programore të shërbimit publik radiodifuziv, si dhe për detyrimet për regjistrimin e shërbimeve programore në Agjenci dhe titrimin e programeve që ritransmetojnë. Gjatë mbikëqyrjes është konstatuar se operatori Vinsat Kabel nga Vinica për përdoruesit e tij ritransmeton shërbimin programor “Super RTL”, i cili nuk mbulohet me çertifikatën për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia.

### Media e shkruar

Agjencia ka kryer mbikëqyrje të rregullt administrative mbi 22 botues të mediave të shkruara për të konstatuar nëse të gjitha të dhënat e publikuara për emrin dhe adresën e selisë dhe redaksisë së medias së shkruar, të dhënat për personin përgjegjës, redaktorët, shtypshkronjën, datën e botimit ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura, në pajtim me detyrimin e Ligjit për Media. Me mbikëqyrje është konstatuar se detyrimet e Ligjit për Mediat nuk i ka përmbushur media “Nova Makedonija”, i cili në botimin nr. 25952 nuk ka publikuar numrin e saktë të kopjeve të shtypura, më pas mediumi “Naroden Lekar”, i cili në botimin nr. 591 nuk ka publikuar datën e saktë të botimit, ndërsa media e shkruar “Slovo” nuk ka publikuar të dhënat për adresën e selisë së botuesit të medias, emrin e personit përgjegjës të botuesit të medias, emrin e shtypshkronjës, adresën e shtypshkronjës, datën e shtypjes ose ribotimit dhe numrin e kopjeve të shtypura.

### Masat e shqiptuara vërejtje publike

Këshilli i Agjencisë, në seancën e 32-të mbajtur më 9 tetor dhe në seancën e 33-të mbajtur më 16 tetor, në bazë të konstatimeve nga mbikëqyrja ku është konstatuar mosrespektim i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Ligjit për Media, miratoi pesë Aktvendime për shqiptimin e masës – vërejtje publike për TV Plus, G-TV Televizion dhe TV Zdravkin.

Televizionit G-TV i janë shqiptuar 3 masa vërejtje publike, nga ku njëra për shkak të transmetimit të programeve artistike pa u shënuar me sinjalistikë për mbrojtjen e të miturve para fillimit dhe gjatë transmetimit të tyre, e dyta për mospublikim të të dhënave për impresium dhe e treta për shkak të mos transmetimit të së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase, as së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuale maqedonase.

Televizionit PLUS vërejtje publike i është shqiptuar për shkak se nuk ka ofruar informacionin që duhet të vihen në dispozicion të përdoruesve, ndërsa për TV ZDRAVKIN për mospublikimin e të dhënave për impresium.

